



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**VENDIM**

**K.P.P. 828/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.12.2018, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr.1529 prot, datë 24.09.2018 për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-70207-05-21-2018 me objekt: “*Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a*” me fond limit 57,704,400 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 31.08.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

**Ankimues:** “Adel Co” shpk  
Rruga Muhamet Gjollësia, Zogu I Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** OSHEE sh.a  
Bulevardi “Gjergj Fishta”, Ndërtesa Nr. 88, H.1, Njësia Administrative

**Baza Ligjore:** Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet dhe pretendimet me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti kontraktor dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:

### I

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, operatori ekonomik ankimues ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### II

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 21.05.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-70207-05-21-2018 me objekt: “Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a” me fond limit 57,704,400 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 31.08.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

II.2. Në datën 31.08.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 03.09.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- Botimet Idea	pa ofertë	I skualifikuar
- ADPS	44,460,000	I kualifikuar
- Kristalina KH	46 800 000	I skualifikuar
- Adel Co	52,852,800	I kualifikuar

II.4. Në datën 10.09.2018 operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor në mënyrë të përmbledhur me argumentet si më poshtë:

- Në DT kapaciteti teknik pika 3 përcaktohet se: 3. Operatori ekonomik duhet të posedojë 3 makineri dixhitale me ngjyra (2 për prodhim normal dhe 1 për rezerve në rast defekti). Disponimi i makinerive duhet vërtetuar me faturë blerje ose dokument zhdoganimi. Edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani tjetër, duhen paraqitur faturat e blerjes/dokumentat e zhdoganimit.

Ju bëjmë me dije se shoqëria ADPS shpk nuk disponon 3 makineri dixhitale printimi për arsyet si mëposhtë: a) Për sa i përket makinerisë Xeikon DCP 500 për të cilën është paraqitur kontratë qeraje financiare me Raiffeisen Leasing kjo shoqëri nuk ka paraqitur faturë blerje apo dokument zhdoganimi sic kërkohet në DT. Ne kemi bindjen se kjo shoqëri ka paraqitur vetëm kontratën e qerasë financiare të lidhur me Raiffeisen Leasing . Mosparaqitja e faturës tatimore të blerjes/dokumentit të zhdoganimit përbën kusht për skualifikim nga kjo procedurë prokurimi pasi kjo shoqëri nuk vërteton se si e ka bërë pronë të sajën Raiffeisen Leasing këto makineri. Mangësia në paraqitjen e faturës apo dokumentit të zhdoganimit tregon që kontrata nuk është paraqitur as në formën e përcaktuar ligjore për aktet noteriale dhe as në formën e kërkuar në DST ku përcaktohet se edhe në rastin e marrjes me qera nga kompani të tjera duhen paraqitur faturat e blerjes/dokumentat e zhdoganimit. Në kushtet kur kjo shoqëri nuk ka paraqitur një dokument që kërkohet në tender duhet të ishte skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi.

b) Kjo kontratë nuk mbulon periudhën e kërkuar të kontratës që prokurohet pasi afati i përfundimit të saj është më datë 31.12.2018 duke mos mbuluar kështu as 1/3 e afatit të kontratës që prokurohet dhe duke mos krijuar kështu siguri për realizimin me sukses të kontratës.

c) Makineritë Xeikon të cilat kjo shoqëri pretendon pronësinë nuk janë në posedim të shoqërisë ADPS pasi në kemi bindjen se kjo shoqëri këto makineri ja ka dhënë me qera shoqërisë Albdesign PSP shpk . Bëhet fjalë për të njëjtat makineri që kalojnë sa në një krah në tjetrin ju bëjme me dije se në kontratën e qerasë janë të njëjtat fatura dhe kartela teknike me printerat që kjo shoqëri ka paraqitur në tenderin pranë institucionit tuaj. Me të drejtën që na jep ligji kërkojmë të dimë se cila kompani i disponon këto makineri dhe kërkojmë nga ana juaj verifikimin e këtij dokumenti pasi është një dokument fallso për të mashtruar institucionet e ndryshme për përfitim nga fondet e buxhetit të shtetit. Bashkëngjitur do gjeni kopje të kontratave për këto makineri për të cilat ju mund të bëni verifikimet përkatëse. Për sa më sipër kërkojmë skualifikimin e këtij operatori nga kjo procedurë dhe propozimin për përshtim pranë APP.

- Në DT kapaciteti teknik pika 4 përcaktohet: 4. Operatori duhet të paraqesë kartelën teknike të makinerive të printimit dixhital nga të cilat duhet të rezultojnë se makinertitë kanë një kapacitet prej 50.000 flete A4/ditë të printuara nga të dyja anët. Shoqëri ADPS nuk e përmbush këtë kërkesë pasi ka paraqitur një kartelë teknike për disponimin e një makinerie për Xeikon DCP 500 D. Kartela teknike e makinerisë Xeikon të pretenduar në kontratën e qerasë financiare nuk përputhet me makinerinë e paraqitur në kontratën e qerasë. Në kontratën Leasing që mund të ketë paraqitur kjo shoqëri përcaktohet Makineri Printimi dixhitale me ngjyra Xeikon DCP 500 . Ndërkohë që kartela teknike e paraqitur është për

*eikon DCP 500 D pra një lloj tjetër makinerie. Ju bëjmë me dije se ADPS ka paraqitur vetëm një kartelë teknike për të treja makineritë dhe dy të tjera mungojnë.*

- *Në DT kërkohet: Operatori ekonomik duhet te disponoje nje soft menaxhimi dhe monitorimi te punes (printimit dhe zarfimit te faturave) ne kohe reale. Per te provuar disponimin e ketij softi duhet te paraqese licensen e softëare-it dhe/ose autorizim prodhuesi/distributorin te softit, fature tatimore blerje, deklarate zhdoganimi ose cdo forme tjeter disponimi qe njeh Kodi Civil i RSH.*

*Autorizimi i prodhuesit të lëshuar nga Xeikon nuk është vlefshëm pasi nuk ka asnjë dokument që të vërtetojë që ky soft i kësaj natyre të vecantë të jetë i inkorporuar në një makineri të caktuar. Pra xeikon me anë të deklaratës së tij mund të vërtetojë që është prodhues i makinerive por nuk vërtetohet me asnjë lloj dokumenti që janë të pajisura me softin e kërkuar. Ju bëjmë me dije se autorizimi që ka lëshuar dega e Xeikon në Greqi nuk është autorizim prodhuesi pra për prodhimin e softit por një autorizim për përdorimin e makinerive. Ky autorizim nuk vlen për përmbushje të kriterit madje krijon paqartësi duke vënë në dyshim pjesën tjetër të dokumentacionit të paraqitur në tender se përse Xeikon autorizon përdorim të makinerive kur ADPS pretendon se i ka në pronësi.*

- *Në DT kapaciteti teknik pika 11 përcaktohet: 11.Operatori ekonomik duhet te jetë i çertifikuar sipas standartit ISO 27001 e vlefshme , për sistemin e sigurisë së informacionit dhe ISO 9001 e vlefshme per menaxhimin e cilesise, objekti i te cilave duhet te perputhet me objektin e kesaj procedure prokurimi.*

*Certifkata ISO e paraqitur nga kjo shoqëri nuk është e vlefshme pasi kopmania vertifikuese që e ka lëshuar këtë certifikatë nuk është e akredituar në fushën e certifikimit të kompanive që operojnë në fushën e shtypshkrimeve. Shoqëria certifikuese nuk është e akredituar për të lëshuar ISO 27001:2013 në rastin e kompanive në fushën e printimit. Gjithashtu mendojmë që kjo trupë certifikuese nuk është e njohur nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit të Shqipërisë në kundërshtim me nenin 30 të VKM nr.914 .*

- *Në pikën 10 të kriterëve kualifikuese përcaktohet që operatori pjesmarrës: Të paraqesë 10 cope fatura sipas të gjitha specifikimeve teknike të kerkuara.*

*Ne mendojmë se ADPS shpk nuk e përmbush këtë kriter të përcaktuar në DT. Nga verifikimet që bëme në ditën dhe hapjen e ofertave ne kemi bindjen se faturat e paraqitura në cilësinë e mostrave nga kjo kompani nuk ishin sipas specifikimeve teknike të përcaktuara nga institucioni juaj në DT. Letra me të cilën është printuar fatura nuk është letër 90 gr lasebond sikurse përcaktohet në specifikimet teknike por është letër me gramaturë më të ulët. Ne kemi bindjen që letra e mostrave të paraqitura është 80 gr në kundërshtim me specifikimet teknike. Ne kërkojmë të realizoni analizën e letrës së modelit të paraqitur nga operatori ADPS si dhe të modelit të paraqitur nga Adel CO pranë një laboratorit të certifikuar për kryerjen e këtyre analizave me qëllim krahasimin dhe nxjerjen në pah të mangësive të modeleve nga operatori në fjalë.*

*Sa më sipër kërkojmë skualifikimin e ADPS shpk dhe shpalljen fitues të shoqërisë Adel CO shpk.*

II.5. Me shkresën nr. 17184/3 prot datë 14.09.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimues duke vendosur mospranimin e ankesës.

II.6. Në datën 24.09.2018 pala ankimuese “Adel Co” shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.7. Nëpërmjet shkresës nr.18206/1 prot, datë 02.10.2018 protokolluar me tonën me nr.1529/2 prot datë 04.10.2018 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.8. Në datën 06.12.2018, operatori ekonomik “Adel Co” shpk ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-70207-05-21-2018 me objekt: “*Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a*” me fond limit 57,704,400 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 31.08.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Adel Co” shpk për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-70207-05-21-2018 me objekt: “*Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a*” me fond limit 57,704,400 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 31.08.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a., Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 “*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*”, i cili, në nenin 94 “*Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës*”, pika 1, parashikon se: “*Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë*”.

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Për sa mësipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

**Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-70207-05-21-2018 me objekt: “*Printim i faturës dhe zarfimi në versionin Selfmailer të OSHEE sh.a*” me fond limit 57,704,400 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 31.08.2018 nga autoriteti kontraktor, OSHEE sh.a.,
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1529 Protokolli; Datë 24.09.2018**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**